



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr Prot 01-693/13
Nr. I faq. 03	Data 07.03.2013
Broj stranica 03	Datum 07.03.2013
Nr. pages 03	Dati 07.03.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.02.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-3916/12, për z. Betim Gjoshi, Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike “Trainkos”, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK–03-3916/12 që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Betim Gjoshi, Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike “Trainkos”, ku është dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit në ushtrimin e Funksionit Publik dhe mos pajtueshmëri në mes të funksioneve si Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike “Trainkos”, dhe angazhimit të tij në veprimtari tjetër si Anëtar i Komisionit Qendror Zgjedhore.

Pasi kemi mbledhur dhe kemi analizuar informata, lidhur me lëndën sipas procedurës zyrtarit të lartë z. Betim Gjoshi, i është bërë shkresa e parë njoftuese me datën 13.11.2012, ku e kemi njoftuar për fillimin e hetimeve lidhur me gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, dhe e kemi njoftuar se ka të drejtë që në afatin ligjor mund të takohet me zyrtarët e Agjencisë për tu njoftuar për situatën.

Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z. Betim Gjoshi, ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë dhe ka shfaqur interesim për një takim që do ta sqaronte situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm interesit.

Me datën 19.11.2012, është mbajtur takimi me z. Gjoshi, dhe është njoftuar për situatën, gjatë takimit zyrtari në fjalë, na ka njoftuar se që nga momenti i përzgjedhjes së tij në funksionin e Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike "Trainkos" e ka njoftuar sekretarin e ndërmarrjes si dhe kryetarin e bordit të drejtoreshave, ku i ka njoftuar lidhur me angazhimin e tij, po ashtu edhe Komisionin Qendror Zgjedhor, e ka njoftuar për zgjedhjen e tij në funksionin e ri, dhe ka kërkuar nga ata që ta njoftojnë se a mundë të ketë ndonjë pengës ligjore, nëse është i angazhuar edhe në një aktivitet tjetër, po ashtu z. Gjoshi, me vullnetin e tij ka kërkuar nga Administrata e KQZ-së, që ti ndalohej çdo kompensim financiar, për shkak se nuk dëshiron që ta marrë asnjë kompensim, pasi që paguhet nga Ndërmarrjes Publike "Trainkos". Zyrtari i lartë z. Betim Gjoshi, na ka njoftuar se mandati i anëtarëve të KQZ-së, fillon jo më vonë se 60 ditë nga certifikimi i zgjedhjeve, d.m.th. që mandati i tyre ka mbaruar, por për shkak të ligjit dhe reformës zgjedhore që është duke u bërë, akoma nuk është bërë emërimi i anëtarëve të rinj, dhe për shkak të kësaj gjendje dhe funksionit tim si ekspert i zgjedhjeve në parti pra në PDK, me dedikim në funksionin e anëtarit të KQZ-së, si përfaqësues i subjektit tim politik, i emëruar nga Presidenti i Republikës, dhe e potencoj se pozita si Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike "Trainkos" dhe gjendja e tanishme reale, që është tash, si Anëtar në Komisionin Qendror Zgjedhor si përfaqësues i një subjekti politik, nuk paraqet mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, i thënë edhe nga udhëheqja e bordit të ndërmarrjes, mirë po do ta respektoj dhe zbatoj çdo vendim që do të del nga ana juaj, dhe pres një trajtim objektiv në këtë proces.

Zyrtari në fjalë na ka informuar se brenda afatit ligjorë do na sjell dëshmitë, të cilat dëshmojnë se i ka njoftuar, zyrtarët të cilët ka qenë i obliguar të njoftoj lidhur me angazhimin e tij në një funksion tjetër.

Me datën 20.11.2012 z. Gjoshi ka sjellë në Agjenci një deklaratë si dhe dëshmitë, lidhur me informimin që ju ka bërë zyrtarëve në institucionet ku ka qenë i obliguar të njoftoj ata se pari, për angazhimin në veprimtari tjera.

Duke u bazuar në nenin 10.1 të Ligjit Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, dhe duke vlerësuar gjendjen faktike dhe në provat e mbledhura si dhe në duke marrë për bazë se zyrtari në fjalë në pozitën e Anëtarit të Komisionit Qendror Zgjedhor ka mandate të cilat konsiderohet të skaduar dhe akoma nuk është përfunduar reforma zgjedhore, si dhe heqje dore nga paga dhe beneficionet tjera, si shenje e transparence e bërë nga zyrtari, dhe mos përfshirja e tij në asnjë komision që merret me çështje financiare dhe për shkak se ripërtëritja e mandateve të KQZ-së nuk është bërë akoma, konstatojmë se : nuk ka elemente të mjaftueshme që dëshmojnë gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit, në ushtrimin e funksionit Publik.

Andaj u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

